



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT

Drejtoria	Drejtoria e Shëndetësisë
Periudha Raportuese	Gusht, 2019
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Dr. Bujar Gashi

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Gjatë muajit qershor 2019, Drejtoria e Shëndetësisë ka pranuar 51 lëndë për t'u shqyrtuar nga komisioni profesional. Stafi në këtë drejtori ka pasur takime të përditshme me qytetarë, për t'u njoftuar me procedura dhe shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- Renovime dhe përmirësimeve të infrastrukturës në objekte shëndetësore;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;
- Inicimi i përgatitjeve administrative, zbatimi i planit të prokurimit 2019;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të Drejtorisë;
- Shqyrtimi i mjeteve të ankimit me rrugë administrative.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:

- Njoftim mbi rezultatet e para të programit nacional për infarkt akut të miokardit, me ST elevim, brenda 120 minutave. Nga data 08.07.2019 deri më 01.08.19, u shpëtuan 3 jetë njerëzish;
- Më 28.08.19, dëgjimi publik “Planifikimi buxhetor 2019 – DSH”;
- Nga 30.08.2019, bashkëpunim DMS dhe DSH, ekipet mjekësore QMU të gatshme për ofrim të shërbimeve shëndetësore në QPS;
- Zhvillimi dhe monitorimi i kontratave:
 - Renovim i hapësirave: radiologjike dhe laboratorike në QMF 5, kati përdhes;
 - Renovime dhe përmirësime të infrastrukturës së objekteve shëndetësore në hapësira të ndryshme, bazuar në gjendjen aktuale të tyre;
 - Takime dhe njoftime të vazhdueshme të ekipit menaxhues;
 - Furnizim me material shpenzues stomatologjik;
 - Furnizim me material shpenzues laboratorik dhe RO Kabineti;
 - Pastrimi i objekteve shëndetësore;
 - Dezinsektimi hapësinor në komunën e Prishtinës;
 - Furnizim me material administrativ shëndetësor;
 - Furnizimi me autoambulanca;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së përditshmërisë të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;
- Takime të vazhdueshme me menaxhmentin e QKMF-së dhe QMU-së në lidhje me përditshmërinë e punës me qytetarë;
- Bashkëpunim me ekipet menaxhuese; Plani i menaxhimit të kontratave – proces prokurimi;
- Procedim përfundimtar i specifikave për procedurë të tenderimit:
 - Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së QMU-së;
 - Procedurë negociuese – Sigurimi fizik i objekteve të KPSH-së;
- Përcaktim ekipit menaxhues:
 - Furnizim me material shpenzues laboratorik dhe RO Kabineti;
 - Furnizim me barna për nevojat e QKMF-së dhe QMU-së;
 - Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve;
- Përcaktimi i ekipit vlerësues:
 - Furnizimi me inventar për nevojat e institucioneve shëndetësore;
- Përpunim i të dhënave – Plani i veprimit për përmirësimin e performancës;

- Realizohet faza e 5-të dhe e 6-të e dezinfektimit në komunën e Prishtinës;
- Takim pune me kolegë DIMK dhe OE rreth projektit “Ndërtimi i QMF-së, Prishtina e Re – Zona perëndim;
- Përgatitje teknike rreth rifunksionalizimit të SISH-së;
- Identifikimi i nevojave dhe përpilimi i buxhetit 2020;
- Rishikim i planprogramit të aktiviteteve për zhvillim të vazhdueshëm profesional;
- Plotësime të Planit të menaxhimit të kontratave të ndryshme;
- Përgatitje teknike mbi procedurat e asgjësimit të barnave dhe materialit shpenzues medicinal;



Gjatë muajit gusht 2019, janë demoluar muret në katin përdhes – QMF 5.

Rrjeti i jashtëm i kanalizimit fekal të objektit është pastruar nga KRU “Prishtina”, më 22.08.2019, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit. Në foto shihen pusetat e mbushura me ujë.



4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Monitorimi i kontratave:

- Furnizim me material administrative shëndetësor;
- Furnizim me material shpenzues stomatologjik;
- Renovime dhe rindërtime;
- Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve shëndetësore të kujdesit primar shëndetësor;
- Dezinsektimi hapësinor në komunën e Prishtinës;
- Mbikëqyrje e vazhdueshme e punës së përditshme të personelit shëndetësor në objektet shëndetësore rreth mbarëvajtjes së punës;
- Organizimi dhe mbajtja e komisioneve për ndarje të subvencioneve – qytetarëve për ndihmë gjatë trajtimit mjekësor.

5. STATISTIKAT

Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

5.1.1. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese.

5.1.2. Takimet me palë

- Rreth 9 – 10 palë gjatë ditëve të punës, janë pranuar, me përjashtim të palëve të pranuar nga drejtori.

5.1.3. Takimet me institucione të tjera:

- Drejtoria e Investimeve Kapitale:
 - Menaxhim i kontratës – Renovime dhe rindërtime;
- Drejtoria e Prokurimit:
 - Procedura rreth kontratave të ndryshme;
- Drejtoria e Pronës:
 - Kushtet ndërtimore – renovimi QMU-së
- Drejtoria e Mirëqenies Sociale:
 - Bashkëpunim në aktivitetin e ndarjes së subvencioneve;

5.1.4. Diskutime publike/Takimet me qytetarë.

5.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Drejtoria e Pronës:
 - Kushtet ndërtimore – renovimi QMU-së.

5.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

- Të pranuar në DSH ishin 51 lëndë, prej të cilave 51 janë në proces.

5.1.7. Përfitues të subvencioneve:

5.1.8. Takime të tjera:

Takime me:

- Ministrinë e Shëndetësisë;
- Zyrën Ndërlidhëse Japoneze – Kosovë;
- Zyrën e Bashkimit Evropian;
- UNFPS-në;
- Organizatën e Shëndetit Mendor.

6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës, apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

- Mungesa e stafit në DSH;
- Mungesa e shefit të sektorit tani e sa vite;
- Numri jo i mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm, sidomos për kategorinë “Mallra dhe shërbime”, ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHËN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve, bazuar në planin e prokurimit;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme;
- Aktivitete për të ngritur cilësinë e shërbimeve shëndetësore.

8. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

AKTIVITETET NË QENDRËN KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE

Aktivitetet vetëdijësuese

Më 04.08.2019, në QKMF në kuadër të aktiviteteve të planifikuara nga Hendikos, është mbajtur Sesi i dytë informues, me qëllim të njoftimit të profesionistëve shëndetësorë mbi llojet e aftësive të kufizuara dhe teknikat e komunikimit. Përveç profesionistëve shëndetësorë, morën pjesë edhe 3 prindër të personave me aftësi të kufizuara.

Më 06. 08. 2019, takim pune në sallën e konferencës në hotel “Sirius” nga ora 09:30 deri 14:00, për raportim online të databazës për Kosovën në WHO-TB.

Më 28. 08. 2019, pjesëmarrje në trajnimin dyditor për psikometri prej orës 09:00-15:00 në QZHMF. Qëllimi i trajnimit ishte ngritja e kapaciteteve për psikometri.

Njësia e Vaksinimit

Bazuar në Kalendarin e imunizimit, vazhdon vaksinimi i qytetarëve të komunës së Prishtinës.

Poliklinika stomatologjike

Numri i pacientëve në shërbimin stomatologjik ishte 6159;

Numri i grafive 673;

Furnizim me material shpenzues stomatologjik nga OE;

Vizitë e vazhdueshme nga kryeshefi mbi përditshmërinë e personelit shëndetësor në ndërrimet e ditës/natës dhe kujdestari;

Nga data 21 gusht deri më 30 gusht 2019, do të mbahen Ditët e flourizmit dhe vulosjes së fisurave të dhëmbëve tek fëmijët.

Për këtë periudhë kohore janë pranuar/furnizuar Barnatorja Qendrore:

BQ është furnizuar nga Ministria e Shëndetësisë, me material tabletar, medicinal shpenzues, material ampullar dhe insulina më 06.08.2019 dhe 23.08.2019;

- OE NSHT “Made Kos”, me material medicinal shpenzues - 16.08.19;
- OE “Lego” SHPK, me material tabletar dhe ampullar - 16.08.19;

Numri i pacientëve insulinë vartës që kanë marr shërbim gjatë muaji gusht ishte 1491.

Vizita mjekësore	Shërbime shëndetësore	Shërbime laboratorike	Shërbime stomatologjike	Shërbime radiologjike	Gjithsej
84075	64460	69783	15698	2222	236238

AKTIVITETET NË QENDRËN E MJEKËSISË URGJENTE

Në QMU gjatë periudhës raportuese është punuar sipas orarit të punës, ku mesatarja e shërbime shëndetësore gjatë 24 orëve ishte rreth 130, përderisa e interevenimeve ishte 60 raste.

Nga raportimet e stafit mjekësor, rastet urgjente janë trajtuar sipas prioriteteve të triazhës dhe sipas këtyre raportimeve kanë dominuar rastet me:

- Intoxikime alimentare,
- Gastroenterokolitit acute,
- Lëndime në aksidentet e trafikut,
- Kriza hipertenzive,
- Reakcionet alergjike,
- Gjendje sinkope etj.

Vizitat shëndetësore vazhduan sipas thirrjeve të qytetarëve, në linjën tel. 194 në Qendrën Dispeçerike.

Gjatë muajt gusht 2019, temperaturat ishin të larta mbi 35°C dhe në këtë situatë, gjatë këtij muaj QMU, me miratimin e DSH-së, ka vendosur një autoambulancë me ekip mjekësor te sheshi "Skënderbeu" për ndihmë qytetarëve. Ekipet kanë qëndruar në shesh gjatë ditës prej orës 10:00 deri 16:00 h, ku qytetarët janë këshilluar për mbrojtjen nga temperaturat e larta.

Mbështetje profesionale e aktiviteteve kulturore-sportive, edukimi dhe trajnimi jashtë orarit të rregullt.

Më 24 gusht, QMU mbështeti aktivitetin "Marshin me biçikleta". Aktiviteti është mbajtur në rrugët e Prishtinës, nga ora 10:00 deri në orën 13:30.

Më 29 gusht, prej orës 17:30 deri në orën 21:30, një ekip mjekësor ka asistuar në stërvitjet e kombëtareve të Kosovës dhe Turqisë, ekipet e gjinisë femërore.

Më 30 gusht, në ditën e ndeshjes, nga ora 18:00 deri në orën 22:30, është asistuar gjithashtu me ekip mjekësor dhe autoambulancë në ndeshjen e kombëtareve femra Kosovë - Turqi. Ndeshja është zhvilluar në stadiumin e qytetit "Fadil Vokrri".

Më 31 gusht, nga ora 10:00 deri 13:00, një ekip mjekësor asistoi në aktivitetin "Vrapojmë për dije". Aktiviteti është mbajtur në sheshin "Zahir Pajaziti" nga komunitetit RAE. Vlen të theksohet se për pjesëmarrje të suksesshme, ekipi që ka përfaqësuar QMU, është nderuar me një mirënjohje. Ekipet me sukses kanë kryer misionin dhe detyrat e ngarkuara.

Me të njëjtën datë, pas kolegjiut të mjekëve në kuadër të EVM-së, është mbajtur ligjëratat e radhës me temat:

- Çrregullimet e ritmit të zemrës (Bradikarditë dhe Tachikarditë);
- Auditi në QMU; Koha e arritjes në vendngjarje për muajt mars - prill - maj 2019.

Shërbimet në muajin gusht 2019 – QMU:

Vizita mjekësore në terren - 1311;
Vizita të tjera mjekësore - 210;
Vizita mjekësore në QMU - 571;
Shërbimi i kirurgjisë së vogël - 34;
Shërbimi i reanimimit terren - 16;
Shërbimi i reanimimit QMU - 19;
Shërbimi observim - 351;
Shërbimi i infermierisë - 146;
Aksidente - 114;
Fatkeqësi në punë - 6;
Fatkeqësi të tjera - 75;
Shërbimi laboratorik - 88;
EKG - 89;
Transportet - 364;
Konstatim vdekje - 40;
Gjithsej: 3434.